

Tirane, 25.5.2023

**AKT THEMELIMI DHE STATUT I SHOQERISE  
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"BOUTIQUE VILLA 1932" SHPK**

**KREU I  
Dispozita te Pergjithshme**

**Neni 1  
Forma Ligjore**

- 1.1** Shoqeria "**BOUTIQUE VILLA 1932**" SHPK themelohet ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" dhe Ligjin Nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" (te ndryshuar), ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar.

**KREU II  
Ortaket, Emri, Objekti, Kohezgjatja dhe Selia**

**Neni 2  
Emri dhe Ortaket**

- 2.1** Shoqeria identifikohet nepermjet emrit te saj "**BOUTIQUE VILLA 1932**" SHPK, ne cilesine e nje personi juridik shqiptar sipas formes "shoqeri me pergjegjesi te kufizuar".
- 2.2** Ortaket e shoqerise jane:
1. Artur Marika, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me 03.09.1969, mbajtes ileternjoftimit me nr. personal G90903105L
  2. Antonio Sadiku, shtetas shqiptar, lindur ne Korce, me 8.8.1989, banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit me nr. personal I90808061Q;

**Neni 3  
Objekti i Aktivitetit**


- 3.1** Hoteleri, bar-kafe, restorant, organizime eventesh dhe sherbime te tjera te ngjashme.
- 3.2** Shoqeria mundet te realizoje cdo lloj operacioni tregtar i cili lidhet ne menyre te drejtperdrejte ose jo me objektin e saj, brenda kufijve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

**Neni  
Kohezgjatja**

- 4.1** Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj tregtar per nje afat te pacaktuar, pervec nese vendoset ndryshe nga organet drejtuese te saj.

**Neni 5  
Selia**

- 5.1** Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga e Durrresit, nr. 65, Tirane, Shqiperi.



- 5.2 Gjate veprimtarise se saj, shoqeria ka te drejte te krijojte dhe hape dege, filiale dhe/ose zyra perfaqesimi edhe ne qytete te tjera, brenda dhe/ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise, ne perputhje me legjislacionin e kerkuar ne fuqi sipas juridiksionit te vendit perkates.

### KREU III

#### Neni 6

#### Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

- 6.1 Kapitali i shoqerise eshte 3.000.000 (tremilion) Leke, dhe ndahet si me poshte:
1. Ortaku Artur Marika: Zoterues i 1 (nje) pjese/kuote qe perben 50 % (pesedhjete perqind) te kapitalit te shoqerise, me vlere prej 1.500.000 (njemilion e peseqindmije) Leke;
  2. Ortaku Antonio Sadiku: Zoterues i 1 (nje) pjese/kuote qe perben 50 % (pesedhjete perqind) te kapitalit te shoqerise, me vlere prej 1.500.000 (njemilion e peseqindmije) Leke.
- 6.2 Kuotat e Kapitalit jane nenshkruar dhe shlyer plotesisht nga Ortaket Themelues.

#### Neni 7

#### Kerkesa per te paguar kuotat dhe terheqja e kuotave te papaguara

- 7.1 Administratori u kerkon ortakeve te shoqerise pagesen e kontributeve te pashlyera ne lidhje me kuotat e tyre dhe çdo ortak (pas marrjes se njoftimit prej 14 (katermbedhjete) Ditesh te Plota ne te cilin percaktohet koha dhe vendi i kryerjes se pageses) i paguan shoqerise shumen e kerkuar per kuotat e zoteruara. Njoftimi per pagese mund te parashikojte shlyerjen me keste te kontributeve te papaguara. Personi te cilit i drejtohet njoftimi per pagesen e kontributit do te jete pergjegjes per njoftimet qe i drejtohen atij pavaresisht kalimit te mepasshem te pronesise se kuotave me te cilat lidhet njoftimi per pagese.
- 7.2 Ne rast se pas njoftimit per shlyerjen e kontributeve pagesa perkatese nuk kryhet brenda afatit te parashikuar, personi pergjegjes per shlyerjen e kontributeve do te paguaje nje interes mbi shumen e papaguar me nje kamatevonese duke filluar nga dita e parashikuar per pagesen. Perlllogaritja e kamatevonesave do te behet sipas ligjit ne fuqi.
- 7.3 Ne rast se pas njoftimit per shlyerjen e kontributeve, pagesa perkatese nuk kryhet brenda afatit te parashikuar, Administratori njofton paraprakisht te paktën 14 (katermbedhjete) Dite te Plota personin pergjegjes per shlyerjen e kontributeve, duke i kerkuar pagesen e shumes se pashlyer se bashku me shumet e mundshme shtese te kamatevoneses. Njoftimi do te permbaje vendin ku duhet te kryhet pagesa dhe deklarimin se ne rast moszbatimi te tij, kuotat te cilave u referohet njoftimi do te anulohen.
- 7.4 Nese pagesa nuk kryhet brenda afatit te njoftimit, kuota me te cilin lidhet njoftimi, perpara se te kryhet pagesa e kerkuar sipas njoftimit, mund te anulohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme dhe anulimi do te perfshije te gjithë dividendet ose shumet e tjera te pagueshme ne lidhje me kuotat e anuluar dhe te papaguara deri ne momentin e anulimit.

- 7.5 Ne pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar mund te shitet, rishperndahet ortakeve ose te kalohet sipas afateve dhe menyrave qe Asambleja e Pergjithshme konsideron te pershtatshme.
- 7.6 Personi, kuota e te cilit eshte anuluar, humbet cilesine e ortakut ne lidhje me kete kuote por do te jete pergjegjes ndaj shoqerise per te gjitha kontributet qe do te shlyheshin nga ky ortak ndaj shoqerise ne daten e anulimit te kuotes se bashku me kamatevonesen e llogaritur per keto kontribute perpara anulimit te kuotes.

#### **Neni 8**

##### **Llojet e Kuotave, te Drejtave dhe Kufizimeve**

- 8.1 Ne perputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cenuar te drejtat qe rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund te emetohen me te drejtat ose kufizimet e parashikuara ne vendimin e Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumicen e kualifikuar (tre te katertat) te votave se ortakeve, ne perputhje me parashikimet e nenit 87 te Ligjit.

#### **Neni 9**


##### **Pronesia dhe Certifikatat e kuotave**

- 9.1 Pronesia mbi kuotat do te regjistrohet ne regjistrin e ortakeve qe do te mbahet ne seline e Shoqerise nen pergjegjesine e Administratorit te saj ("Regjistri i Ortakeve").
- 9.2 Regjistri i Ortakeve do te pasqyroje informacionin e meposhtem: (i) identitetin e cdo Ortaku; (ii) numrin e kuotave qe i perkasin cdo Ortaku; (iii) vleren nominale te kuotave; (iv) daten e fitimit te pronesise mbi kuotat nga cdo Ortak; (v) adresen apo seline e cdo Ortaku; (vi) detaje per cdo peng apo barre mbi kuotat.
- 9.3 Ortaket kane te drejte, nepermjet paraqitjes se nje kerkese me shkrim, te kerkojne nje ekstrakt te Regjistrit te Ortakeve, me vulen e Shoqerise.
- 9.4 Ortaket kane te drejte te verifikojne regjistrimin e tyre ne Regjistrin e Ortakeve dhe Administratori, nese i kerkohet me shkrim, do t'u jape Ortakeve ndihmen e nevojshme per kete qellim.
- 9.5 Te gjitha transferimet e kuotave do te behen ne perputhje me legjislacionin shqiptar te zbatueshem dhe kete Statut dhe do te regjistrohen ne Regjistrin e Ortakeve.
- 9.6 Secili ortak ka te drejte te perfitoje nje certifikate per kuoten e zoteruar prej tij. Shoqeria nuk eshte e detyruar te leshoje me shume se nje certifikate per kuotat e zoteruara bashkerisht nga disa persona dhe dorezimi i certifikates ndaj perfaqesuesit te zoteruesve te perbashket te kuotave do te konsiderohet si dorezim i kryer ndaj te gjitha zoteruesve te kuotave, ne perputhje me piken 2 te nenit 72 te Ligjit. Emrat e zoteruesve te perbashket te kuotave do te renditen ne certifikaten e kuotes. Ne asnje rast Certifikata nuk do te gezoje cilesine e letres me vlere.

#### **Neni 10**


##### **Kalimi me Kontrate i Kuotave**

- 10.1 Kontrata e kalimit te kuotes behet me shkrim dhe sipas formaliteteve te percaktuara nga Administratori. Kjo kontrate do te dergohet ne seline e shoqerise.
- 10.2 Administratori mund te refuzoje regjistrimin e kalimit te kuotes ne QKB ne rast se kjo kuote nuk eshte shlyer plotesisht ose ne rrethana te tjera te cilat e bejne te pamundur kete regjistrim.



- 10.3** Nëse Administratori refuzon të regjistrojë kalimin e kuotes, ai do të njoftojë Asamblenë e Ortave brenda një afati 5 ditësh nga data në të cilën është paraqitur në shoqëri kërkesa për regjistrimin e kalimit të kuotes.
- 10.4** Kalimi i të drejtave, venia peng, barre apo çdo mëjet tjetër sigurimi mbi kuotat do të kërkojë - në mënyrë që të prodhojë efekt - miratimin paraprak të Asamblesë së Përgjithshme - e cila do të marrë vendim me shumicë të cilesuar.
- 10.5** Nëse një Ortak ka për qëllim të shesë apo transferojë në çdo formë të gjitha apo një pjesë të kuotave të tij një personi të ndryshëm nga Ortaket, Ortaket e tjera kanë të drejtën e parablerjes mbi të gjitha apo një numër të Kuotave të Ofruara. Kjo e drejtë parablerjeje mund të ushtrohet vetëm në përputhje me procedurën e mëposhtme të përcaktuar në nenin 10.6 deri në 10.8.
- 10.6** Nëse një Ortak ka për qëllim të shesë apo transferojë të gjitha apo një pjesë të kuotave të tij ("*Kuotat e Ofruara*"), ai - përpara se të nënshkruajë marrëveshje me persona të ndryshëm nga Ortaket - do të njoftojë me shkrim Administratorin, për shitjen apo transferimin e planifikuar, ku të përcaktojë gjithashtu edhe cmimin e shitjes/transferimit.
- 10.7** Administratori brenda 10 ditëve duke filluar nga dita kur është njoftuar nga Ortaku për shitjen apo transferimin e planifikuar - do të informojë me shkrim Ortaket e tjera.
- 10.8** Ortaket e tjera që kanë të drejtën e parablerjes sipas nenit 10.5 - brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi prej Administratorit për shitjen apo transferimin e planifikuar do të njoftojnë me shkrim Administratorin nëse kanë qëllim të ushtrojnë të drejtën e tyre të parablerjes. Administratori - brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e këtij njoftimi - duhet të njoftojë Ortakun që ka për qëllim të shesë/transferojë kuotat e tij.
- 10.9** Nëse asnjë njoftim nuk është dhënë nga Ortaket sipas nenit 10.8 me siper, Ortaku që ka për qëllim të shesë/transferojë kuotat e tij do të jetë i lirë t'ia shesë/transferojë keto kuota një pale të tretë. Në asnjë rast cmimi apo kushtet e shitjes tek një pale e tretë nuk mund të jetë i njëjte ose me kushte më pak të favorshme se cmimi apo kushtet e ofruara ortave të shoqërisë.
- 10.10** Nëse Ortaku që ka për qëllim të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes ka dhënë njoftim, ky Ortak do të ketë të drejtë të blejë Kuotat e Ofruara - pjesërisht apo tërësisht, sic përcaktohet në njoftimin e tij - brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të njoftimit të tij tek Administratori. Në rast blerjeje të pjesëshme të Kuotave të Ofruara - në çdo rast në përputhje me numrin e përcaktuar në njoftimin e dërguar nga Ortaku blerës - pjesa e mbetur e Kuotave të Ofruara mund t'i ofrohet dhe të transferohet tek çdo pale e tretë me një cmim shitjeje/transferimi jo më të ulët sesa ai i përcaktuar në njoftimin e përmendur në nenin 10.6.
- 10.11** Çdo shitje apo transferim kuotash që nuk kryhet në përputhje me parashikimet e këtij neni është i pavlefshëm dhe nuk ka efekte ligjore për Shoqërinë.
- 10.12** Pavarësisht nga sa më siper, nëse Ortaku i cili vendos të shesë kuotat e tij ose një pjesë të tyre arrin një marrëveshje paraprake me një apo me shumë ortave të tjera (ketu nuk përfshihen të gjithë ortaket e shoqërisë) atëherë ai është i lirë të shesë tek ortaku apo ortaket e tjera (ketu nuk përfshihen të gjithë ortaket e shoqërisë) pa qenë nevoja të ndiqen parashikimet e mësipërme. Në këtë rast, Administratori është i detyruar të ndjekë menjëherë procedurat e nevojshme për realizimin e shitjes së kuotave ose të një pjesë të tyre.

Neni 11



## **Kalimi i kuotave me Trashegimi ose si pasoje e Falimentimit**

- 11.1** Nese nje ortak vdes, trashegimtari ose trashegimtaret ne rastin e bashkezoterimit te kuotave, dhe trashegimtaret e tij ne rast se ky person ishte zoterues ose trashegimtar i vetem i bashkezoteruesve te kuotave, do te jene personat e vetem te njohur nga shoqeria si gezues se te drejtave mbi kuoten e tij; pavaresisht parashikimeve te ketij Statuti, pasuria e ortakut te vdekur nuk çlirohet nga pergjegjesia ne lidhje me kuoten e zoteruar nga ai vetem apo se bashku me persona te tjere.
- 11.2** Personi qe fiton te drejten mbi nje kuote si pasoje e vdekjes ose falimentimit te nje ortaku, pas paraqitjes se provave te kerkuara nga Administratori, mund te zgjedhe te behet zoterues i kuotes ose te kerkoje regjistrimin e kuotes ne emer te nje personi tjetër te caktuar prej tij si perfitues te kuotes. Nese personi i mesiperm zgjedh te behet zoterues i kuotes, ai njofton shoqerine ne lidhje me kete zgjedhje. Nese ky person zgjedh qe nje person tjetër te regjistrohet si zoterues i kuotes, ai kalon kuoten ne dobi te personit tjetër.
- 11.3** Personi qe fiton te drejta mbi nje kuote si pasoje e vdekjes ose falimentimit te nje ortaku do te kete te drejtat qe gezonte zoteruesi i kuotes, duke perjashtuar te drejten e pjesemarrjes ose te votes ne çdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme, deri ne momentin e regjistrimit ne QKB.

### **Neni 12**

#### **Zmadhimi dhe Zvogelimi i Kapitalit Themeltar**

- 12.1** Asambleja e Pergjithshme, me shumice te kualifikuar, mund te zmadhoje kapitalin themeltar te shoqerise duke rritur kuotat e ortakeve ekzistues ne shumen e percaktuar ne vendimin perkates. Zmadhimi i kapitalit me qellim pranimin e ortakeve te rinj ne shoqeri, miratohet nga Asambleja e Pergjithshme me shumicen e kualifikuar te votave te ortakeve.
- 12.2** Shoqeria mund te vendose zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise me vendimin e Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumicen e kualifikuar te votave, duke pasur parasysh qe te respektohet minimumi i parashikuar nga Ligji per Shoqerite Tregtare.

### **Neni 13**

#### **Blerja e Kuotave te Veta**

- 13.1** Shoqeria mund te bleje kuotat e veta dhe te kryeje pagesa per blerjen e tyre, jo nga fitimet e shoqerise qe do t'u shperndahen ortakeve apo emetimi i kuotave te reja vetem nese shoqeria permbush kushtet per shperndarjen e fitimeve sipas nenit 77 te Ligjit dhe Administratori leshon nje certifikate te aftesise paguese te parashikuar nga ky nen. Ne rast se blerja e kuotave te veta nuk eshte ne perputhje me kushtet e nenit 77 te Ligjit, padite mbi pergjegjesine e shoqerise mund te ngrihen ne pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 te Ligjit.


## **Kreu IV**

### **Asambleja e Pergjithshme**

### **Neni 14**

#### **Kompetencat dhe Thirrja e Asamblese se Pergjithshme**

- 14.1** Asambleja e Pergjithshme do te jete organi me i larte i Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme do te vendose, por pa u kufizuar, per çeshtjet e meposhtme te Shoqerise:



- a. percaktimi i politikave tregtare;
  - b. ndryshime te Statutit;
  - c. emerimi dhe shkarkimi i administratorit/administratoreve;
  - d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel te autorizuar;
  - e. miratimi i skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c. dhe d.;
  - f. mbikeqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga ana e administratorit/administratoreve, duke perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve mbi ecurine e aktivitetit te Shoqerise;
  - g. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve mbi ecurine e aktivitetit te Shoqerise;
  - h. zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit;
  - i. pjesetimi i kuotave dhe anulimi i tyre;
  - j. perfaqesimin e shoqerise ne gjykime dhe ne procedime te tjera kunder administratorit/administratoreve te saj;
  - l. riorganizimi dhe prishja e Shoqerise;
  - m. miratimi i rregullave procedurale te mbledhjeve te saj;
  - n. ceshtje te tjera te parashikuara nga Ligji per Shoqerite Tregtare dhe Statuti.
- 14.2** Asambleja e Pergjithshme merr vendime per ceshtjet e permendura ne pikat (g) dhe (h) me siper pas shqyrtimit te dokumentacionit perkates.
- 14.3** Administratori therret Asamblene e Pergjithshme dhe, me kerkesen e ortakeve sipas nenit 84 te Ligjit, do te procedoje me thirrjen e Asamblese se Pergjithshme.
- 14.4** Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi te derguar me poste (ose me format tjeter komunikimi perfshire edhe ate elektronik) drejtuar çdo ortaku, perfshire edhe perfaqesuesin e kuotave ne zoterim te perbashket. Njoftimi duhet te kryhet te pakten 7 (shtate) Dite te Plota perpara dates se caktuar per mbledhjen perveç rasteve kur njoftimi i mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme i çili permban nje afat me te shkurter eshte miratuar nga shumica e ortakeve te cilet zoterojne jo me pak se nentendhete per qind te vleres nominale te kuotave.
- 14.5** Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te permbaje ne menyre te qarte daten, ditën, kohen, vendin dhe rendin e dites te mbledhjes, informacion mbi vendin dhe menyren e marrjes se dokumenteve dhe te projekt-vendimeve qe duhet t'u vihen ne dispozicion dhe do t'u dergohen te gjithe Ortakeve te Shoqerise te pakten 7 (shtate) dite perpara mbledhjes.
- Ne rast ndryshimi te rendit te dites, do te ndiqet e njejta procedure njoftimi qe pershkruhet me siper.
- Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit, Asambleja mblidhet perseri brenda 30 diteve me te njejtin rend dite.
- 14.6** Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme jane te pavlefshme ne rast moskryerje te qellimshme se njoftimit apo mos-marrjes se njoftimit te mbledhjes nga personat te cilet kane te drejte te marrin kete njoftim, me perjashtim te rastit kur shoqeria provon se personi i ka dhene shoqerise nje adrese te pasakte.

## Neni 15 Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme

- 15.1** Asambleja e Pergjithshme merr vendime te vlefshme vetem me arritjen e kuorunit te parashikuar nga neni 86 dhe 87 i Ligjit. Ortaket ose perfaqesuesit e autorizuar mund te marrin pjese nepermjet mjeteve elektronike, perfshire telekonferencen (*conference call*), audio ose audio-video, ne perputhje me nenin 88 te Ligjit.
- 15.2** Kryetari i mbledhjes caktohet me shumice te thjeshte te kuorunit te parashikuar nga neni 86 dhe 87 i Ligjit, i cili cakton nje person per te mbajtur procesverbalin e mbledhjes.
- 15.3** Administratori, pavaresisht nese nuk eshte ortak, ka te drejten e pjesemarrjes si edhe te marre fjalen ne çdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme.
- 15.4** Kryetari, me pelqimin e Asamblese se Pergjithshme te mbledhur ne perputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe eshte i detyruar nese kerkohet nga Asambleja e Pergjithshme), te shtyje mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, por ne mbledhjen e dyte mund te diskutohen vetem ato çeshtje te cilat do te ishin diskutuar rregullisht nese nuk do te ishte shtyre mbledhja e meparshme. Kur mbledhja e Asamblese se Pergjithshme shtyhet te pakten katermbledhete dite, njoftimi do te kryhet te pakten shtate Dite te Plota perpara kesaj date dhe ne te do te percaktohet ora dhe vendi i mbledhjes se shtyre dhe pershkrimi i pergjithshem i rendit te dites. Ne rast te kundert, dhenia e njoftimit nuk eshte e nevojshme.
- 15.5** Me perjashtim te kundershimit te nje ortaku, Kryetari deklarone nese vendimi eshte marre ne menyre unanime, ose me nje shumice te caktuar, nuk eshte miratuar ose nuk eshte miratuar me nje shumice te caktuar dhe regjistrimi perkates ne procesverbalin e mbledhjes perben prove perfundimtare te ketij fakti, pa pasur nevojte per numerimin e votave te regjistruara pro ose kunder vendimit.
- 15.6** Ne rast se ka kundershitime per kete deklarate, do te zhvillohet edhe nje votim tjetere ne lidhje me percaktimin e numrit te votave pro dhe kunder vendimit.

#### **Neni 16**

##### **Votat e Ortakeve**

- 16.1** Ne perputhje me te drejtat ose kufizimet qe rrjedhin nga kuotat, çdo kuote i jep ortakut (ne rastin kur eshte individ) te pranishem apo perfaqesuesit te tij te autorizuar ose ortakut (ne rastin kur eshte person juridik) i cili eshte i pranishem permes perfaqesuesit ligjor apo perfaqesuesit te autorizuar ne menyre te rregullt, te drejten e nje vote.
- 16.2** Asnje ortak nuk do te votoje ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, personalisht ose nepermjet perfaqesuesve, ne lidhje me kuoten e zoteruar prej tij, nese nuk ka shlyer teresisht detyrimet qe kane te bejne me kete kuote.
- 16.3** Çdo kundershitim ne kohe per cilesine e nje votuesi do ti komunikohet Kryetarit, vendimi i te cilit do te jete perfundimtar. Te gjitha votat e pakundershtuara ne nje mbledhje ose mbledhje te shtyre do te jene te vlefshme.

#### **Neni 17**

##### **Votimi me Prokure**

- 17.1** Perfaqesuesi do te emerohet nga ortakut nepermjet nje akti noterial sipas nje forme te percaktuar dhe miratuar nga Administratori. Cdo ortak nepermjet perfaqesuesit te tij mund te zgjedhe te votoje "PRO", "KUNDER" ose "ABSTENIM".

- 17.2 Akti perkates noterial i perfaqesimit depozitohet ne seline e shoqerise ose ne nje vend tjeter brenda territorit te Republikes se Shqiperise, siç percaktohet ne njoftimin per mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme ose ne ftesen per te caktuar nje perfaqesues te derguar nga shoqeria ne lidhje me mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme. Akti i emerimit te perfaqesuesit duhet te depozitohet jo me vonë se 48 ore perpara ores se mbledhjes ose mbledhjes se shtyre, ne te cilen duhet te votoje perfaqesuesi.
- 17.3 Ne rast se akti i emerimit te perfaqesuesit jepet nepermjet komunikimit elektronik te derguar ne adresen elektronike (*email*) te shoqerise, ky akt duhet te merret jo me vonë se 48 ore perpara ores se mbledhjes ose mbledhjes se shtyre ne te cilen duhet te votoje perfaqesuesi.

#### **Neni 18** **Hetimet e posaçme**

- 18.1 Personi ose personat qe plotesojne kushtet per te kerkuar emerimin apo zevendesimin e nje eksperti te fushes sipas nenit 91 te Ligjit paraqesin nje kerkese te tille nepermjet depozitimit te nje deklarate noteriale ne seline e shoqerise e cila verteton se personi ose personat plotesojne kushtet per kryerjen e ketij veprimi.


### **Kreu V** **Administratori**

#### **Neni 19** **Emerimi i Administratorit**

- 19.1 Asambleja e Pergjithshme zgjedh nje ose me shume persona fizike si Administratore te shoqerise per nje periudhe njevjecare, ne pajtim me parashikimet e shkronjes "c" te pikes 1 te nenit 81 dhe nenit 95 te Ligjit. Emerimet do te jene individuale dhe sipas nje vendimi te marre me shumice te zakonshme nga Asambleja e Pergjithshme, i cili, nese miratohet, sjell emerimin e personit te propozuar si Administrator.
- 19.2 Kufizimet ne lidhje me emerimin e Administratoreve parashikohen ne piken 2 te nenit 95 te Ligjit.
- 19.3 Personi i meposhtem caktohet si Administrator i shoqerise:  
Antonio Sadiku, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me 8.8.1989, banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit me nr. Personal I90808061Q.
- 19.4 Administratori do te emerohet per nje periudhe prej 5 vitesh, me te drejte riperseritje.

#### **Neni 20** **Kompetencat e Administratorit**

- 20.1 Administratori ka te drejte dhe detyrohet te:
- kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
  - perfaqesoje shoqerine tregtare;
  - kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
  - pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
  - krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;





- dh) kryeje regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- e) raportoje perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- e) kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

**20.2** Administratoret jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, ne rastet kursipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.


**20.3** Nese asambleja e pergjithshme emerom me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

**20.4** Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.


## **Neni 21**

### **Pergjegjesite e Administratorit**

- 21.1** Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.  
Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.
- 21.2** Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:
- a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te veçante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;
  - b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
  - c) te vleresoje me pergjegjesi çeshtjet, per te cilat merret vendim;
  - ç) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;
  - d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.
- 21.3** Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjen ndaj shoqerise per çdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.
- 21.4** Nese administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 21.1 e 21.2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.



- 21.5** Ne menyre te veçante, por pa u kufizuar ne to, Administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundershtrim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e meposhtme:
- a) u kthen ortakeve kontributet;
  - b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;
  - c) u shperndan aktivet shoqerise;
  - ç) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;
  - d) jep kredi.
- 21.6** Perveç padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht Administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit
- Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.
- 21.7** Pa u kufizuar sa me siper, ne menyre te vecante Administratori ka keto kompetenca:
- (i) do te drejtoje dhe te perfaqesoje Shoqerine persa i perket administrimit te zakonshem;
  - (ii) do te hape llogari ne emer te Shoqerise me cdo banke qe kryen aktivitet ne Shqiperi ose jashte saj
  - (iii) do te pergatise te gjitha planet per marrjen e financimeve, do te nenshkruaje cdo kontrate huaje apo kontrate tjeter qe parashikon nje borxh apo borxh te mundshem per Shoqerine, hipoteke, peng apo cdo marreveshje tjeter qe krijon apo mund te krijojë nje barre mbi pasurite e Shoqerise, marreveshje garancie, kontrate per shitjen e pasurive te paluajtshme apo te luajtshme te Shoqerise. Te gjitha veprimet e parashikuara ketu (pika iv) do te jene te vlefshme nese jane te autorizuar shprehimisht me ane te nje Vendimi te Asamblese se Pergjithshme te marre me shumice te cilesuar;
  - (iv) do te urdherojë dhe kryejë pagesa ne emer te Shoqerise duke nenshkruar dokumentet / instrumentet e pagesave;
  - (v) do te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te Shoqerise;
  - (vi) do te pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, ia paraqet per miratim Asamblese se Pergjithshme;
  - (vii) do te krijojë nje sistem monitorimi dhe paralajmerimi njoftimi te hershem per rrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;
  - (viii) do te kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoqerise, sipas kerkeseve te Ligjit nr. 9723, date 3 Maj 2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
  - (ix) do t'i raportoje Asamblese se Pergjithshme per zbatimin e politikave tregtare dhe per realizimin e veprimeve me rendesi te veçante per veprimtarine e Shoqerise;
  - (xii) do te marre ne pune, emerojë, shkarkojë te punesuar te Shoqerise per cdo nivel, perfshire edhe te punesuar me kohe te pjesshme, konsulente, agjente, do te percaktojë kompetencat dhe detyrat e tyre si dhe do te percaktojë shperblimin e tyre;
  - (x) te kryejë detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin per Shoqerite Tregtare, duke pasur parasysh respektimin ne cdo rast te kufizimeve te parashikuara nga ky Statut, si dhe detyrat e dhena me Vendim te Asamblese se Pergjithshme.



## **Neni 22**

### **Shperblimi, Perfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratorit**

- 22.1** Administratori shperblehen ne baze te skemes se vendosur nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me parashikimet e nenit 97 te Ligjit.
- 22.2** Asambleja e Pergjithshme mund te parashikojte perfitime, nepermjet shperblimeve ne para, pensione, sigurime ose forma te tjera, per çdo person i cili ka qene por nuk eshte me ne detyre apo i punesuar ne shoqeri, shoqeri te tjera te cilat jane ose kane qene shoqeri te kontrolluara ose per shoqeri paraardhese te shoqerise ekzistuese ose te filialeve te saj, ose per çdo familjar te tyre (perfshire bashkeshortin/en, ish-bashkeshortin/en) ose persona te cilet jane ose ishin ne varesi te tyre, dhe mund te paguaje kontribute ne fonde te caktuara per dhenien e perfitimeve te tilla.
- 22.3** Administratorit mund t'iu paguhen te gjitha shpenzimet e udhetimit, akomodimit dhe shpenzime te tjera ne lidhje me pjesemarrjen e tyre ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme apo mbledhje te tjera ne lidhje me permbushjen e detyrave te tyre.

## **Neni 23**

### **Kufizimet ne Veprimet e Administratorit**

- 23.1** Administratori nuk do te lidhi marreveshje per çeshtje ne te cilin ai ka, direkt ose indirekt, nje interes apo detyrim i cili eshte material, qe eshte apo mund te jete ne kundërshtim me interesat e shoqerise, ne pajtim me nenin 13 te Ligjit, deri ne momentin kur ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, te gjithë anetaret kane rene dakord qe te autorizojne lidhjen e kesaj marreveshje.
- 23.2** Autorizimi mund te jete i pergjithshem ose i posaçem per nje çeshtje te caktuar. Autorizimi i pergjithshem duhet te regjistrohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

## **Kreu VI**

### **Dividendet dhe Kalimi i Fitimeve ne Kapitalin Themeltar**


## **Neni 25**

### **Dividendet**

- 25.1** Pas plotesimit te parashikimeve te nenit 77 te Ligjit, shoqeria me shumice te kualifikuar te votave se Asamblese se Pergjithshme mund te deklaroje shperndarjen e dividendeve ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve.
- 25.2** Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga te drejtat qe lidhen me kuotat, te gjithë dividendet deklarohen dhe paguhen ne perputhje me shumat e paguara per kuotat per te cilet paguhet dividendi. Te gjithë dividendet pjesetohen dhe paguhen ne perpjesetim te drejte me shumat e paguara per kuotat, pjeses ose pjeseve te periudhes per te cilen paguhet dividendi; ne rast se kuota emetohet me kushtin e perfitimit te dividendit nga nje date e caktuar, dividendi do te paguhet ne perputhje me kete kusht.
- 25.3** Asnje dividend ose pagese ne para qe lidhet me nje kuote nuk do te mbarte interesa ndaj shoqerise nese nuk parashikohet nga te drejtat qe lidhen me kuoten.

## **Neni 26**

### **Kalimi i Fitimeve ne Kapitalin Themeltar**



- 26.1** Administratorit, pas vendimit te marre nga Asambleja e Pergjithshme me shumice te kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e percaktuara ne nenin 14 te Ligjit, kryen te gjitha veprimet per te kaluar ne kapitalin themeltar te shoqerise fitimet e pashperndara te cilat nuk do te perdoren per te paguar dividende preferenciale apo shuma te tjera te parashikuara per rezervat e kapitalit te shoqerise.

## **Kreu VII Prishja dhe njoftimet**

### **Neni 27 Prishja dhe likuidimi**


- 27.1** Shoqeria priset dhe kalon ne procedura likuidimi nese:
1. merret nje vendim i posacem i Asamblese se Pergjithshme;
  2. kalohet ne falimentim;
  3. ekziston nje vendim gjykate;
  4. per arsye te tjera te parashikuara ne kete Statut.
- 27.2** Ne rast te likuidimit te shoqerise, likuiduesi, ne perputhje me Ligjin dhe me vendimin e marre me shumicen e kualifikuar se votave te Asamblese se Pergjithshme, mund te shperndaje ne dobi te ortakeve te gjitha ose nje pjese te vleres se pasurive te shoqerise dhe per kete qellim, mund te vleresoje cdo pasuri dhe te percaktoje menyren e shperndarjes midis ortakeve te shoqerise.
- 27.3** Administratori eshte i detyruar te regjistroje prishjen e Shoqerise ne QKB, me perjashtim te rastit kur prishja behet me vendim gjykate; ne kete rast eshte gjykata qe i dergon njoftimin QKB-se.

### **Neni 28 Njoftimet**

- 28.1** Njoftimet e kryera nga cdo person sipas parashikimeve te Statutit, duhet te jene me shkrim ose (nese zbatohet) nepermjet komunikimit elektronik ne adresen e parashikuar sipas pikes 3 te nenit 4 te ketij Statuti dhe jane te vlefshme ne lidhje me kohen e njoftuar per kete qellim dhe personin qe kryen njoftimin.
- 28.2** Shoqeria mund te njoftoje nje ortak personalisht ose duke e derguar njoftimin me leter porosi me kthim pergjigje ne adresen e regjistruar te ortakut ose ne adresen apo posten elektronike (nese ka) qe i eshte njoftuar shoqerise nga ortakut. Kur ka disa bashkezetues te nje kuote, te gjitha njoftimet i jepen perfaqesuesit te tyre te perbashket ne perputhje me piken 2 te nenin 72 te Ligjit.
- 28.3** Ky Statut se bashku me ndryshimet dhe te gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhena nga shoqeria do te publikohet nga Administratoret ne faqen e internetit te shoqerise, sipas parashikimeve te pikes 2 te nenit 4 te ketij Statuti (nese zbatohet).

### **Neni 29 Te Ndryshme**

- 29.1** Cdo dokument qe leshohet per dhe ne emer te shoqerise eshte i pavlefshem nese nuk mban vulen e saj.



- 29.2** Te gjitha marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen me Kodin e Punës dhe çdo akt tjetër ligjor dhe nënligjor të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, në fuqi dhe në veprim kohe pas kohe gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit të saj tregtar.
- 29.3** Viti financiar zgjat 12 (dymbëdhjetë) muaj, duke filluar me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.
- 29.4** Në fund të çdo viti financiar, Administratori harton bilancin vjetor dhe raportin e administrimit, të cilet i dërgohen për miratim Asamblesë së zakonshme.
- 29.5** Për të gjitha çështjet që nuk janë parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 29.6** Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.
- 29.7** Në këtë statut:
1. “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
  2. “Statuti” është Statuti i shoqërisë;
  3. “Dite të Plota” në lidhje me periudhën e një njoftimi është periudha që nuk e përfshin ditën kur është dhënë ose kur konsiderohet se është dhënë njoftimi dhe ditën për të cilën është dhënë ose hyn në fuqi njoftimi.

**Ortaket e Shoqërisë**  
**“BOUTIQUE VILLA 1932” SHPK**

**Artur Marika**



**Antonio Sadiku**

